

**OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT SH.A.
OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMISIONIT DHE TREGUT SH.A.
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË BURSA SHQIPTARE E
ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A. (ALPEX)**

**VENDIM
I
ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME**

Nr. 3, datë 07 / 03 /2025

**“PËR ZMADHIMIN E KAPITALIT TË BURSËS SHQIPTARE TË ENERGJISË
ELEKTRIKE SHA”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), nenit 6, pika 6; nenit 12, paragrafi 2, gërma “b” dhe nenit 17, paragrafi 1, gërma “t”, të Statutit të shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX SHA, në bazë raportit nr. 30 prot. datë 11.11.2024 të Këshillit Mbikëqyrës të ALPEX drejtuar Asamblesë së Përgjithshme “Dërgohet raport mbi nevojën e shoqërisë ALPEX SHA për zmadhimin e kapitalit të saj”, Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX SHA;

VENDOSI:

1. Kapitali themeltar të zmadhohet për vlerën 200,000,000.00 (dyqind milion) Lekë për shoqërinë Bursa Shqiptare të Energjisë Elektrike SHA.
2. Shlyerja e kapitalit shtesë të bëhet me kontribute në para, 50% e vlerës deri në tre mujorin e parë të vitit 2025 dhe pjesa e mbetur prej 50% deri në fund të vitit 2025.
3. Kapitali ishte 250,000,000.00 (dyqind e pesëdhjetë milion) Lekë bëhet 450,000,000.00 (katërqind e pesëdhjetë milion) Lekë dhe vlera nominale e aksioneve ishte 1.000,00 (një mijë) Lekë secila bëhet 1.800,00 (një mijë e tetëqind) Lekë secila.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË BURSA SHQIPTARE E
ENERGJISË ELEKTRIKE SH.A. - ALPEX**

Për Aksionarin OST sh.a.

**ADMINISTRATORI
ELISIAN BICI**

Për Aksionarin KOSTT sh.a.

**KRYESHEFI EKZEKUTIV
EVETAR ZEQIRI**